

Bazuar në nenin 158-g pika 1) dhe në lidhje me nenin 122 paragrafi (1) pika 2) dhe 3) të Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019 dhe 31/2020), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve nxori

## **RREGULLORE<sup>1</sup>**

### **për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimve dhe/apo risigurimeve**

#### **I. Dispozita të përgjithshme**

##### **Neni 1**

(1) Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e raporteve të cilat shoqëria për sigurim dhe/apo risigurim (në tekstin e mëtejshëm: shoqëri e sigurimeve) i përpilojnë si shtesë ndaj raporteve financiare të përcaktuara me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare dhe përmbajtje e detajuar e raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim (në tekstin e mëtejshëm: raporte financiare shtesë) dhe mënyrën dhe afatet e dorëzimit të tyre te Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

(2) Raportet financiare shtesë të paragrafit 1 të këtij neni, shoqëritë e sigurimeve e përpilojnë në bazë të të dhënave nga regjistrat e tyre të punës, në të njëjtën mënyrë si edhe gjatë përpilimit të raporteve financiare.

#### **II. Raporte financiare shtesë**

##### **Neni 2**

(1) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet vjetore financiare shtesë në vijim:

1. Raport për norma jashtë bilancit (NorJB);
2. Raport për pajtueshmëri valutore (PV);
3. Raport për pajtueshmëri të afatit (PA);
4. Raport për transaksione me persona të lidhur (TmePL);
5. Raporti i strukturës së kapitalit aksionar (SKA).

(2) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet financiare tremujore shtesë në vijim:

1. Raport për të ardhura dhe shpenzime nga investimet (AdheSHngal);
2. Raport për fitime (humbje) të realizuara nga shitja – fitimi (humbja) kapital (FRngal);
3. Raport për përshtatje me vlerë (fitime jo të realizuara (humbje), redukim i vlerës objektive) (FJRngal);
4. Raport për investime të cilat nuk i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo atë matematik;

---

<sup>1</sup> Teksti i konsoliduar i Rregullores është hartuar në bazë të tekstit të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimve dhe/apo risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2012), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimve dhe/apo risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2016), Rregullorjes për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimve dhe/apo risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 39/2019) dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimve dhe/apo risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/2022). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime ligjore janë të vlefshme vetëm tekstet e lartpërmendura të shpallura në Gazetën Zyrtare.

5. Raport për strukturën e investimeve (SIn).

(3) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet financiare shtesë të cituara në paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni në përputhje me formën dhe përmbajtjen e të njëjtëve, të përcaktuar me formularët-Raporte shtesë financiare të shoqërive të sigurimeve, të cilat janë dhënë në Aneksin 1 të kësaj rregullore dhe janë pjesë përbërëse e tij.

1

(4) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet shtesë financiare të cituara në paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni në përputhje me Udhëzimin për plotësim të raporteve shtesë financiare i cili është dhënë në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e tij.

(5) Të gjitha shumat në raportet shtesë financiare shprehen në denarë.

### **III. Mënyra dhe afatet e raportimit** **Neni 3**

(1) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet shtesë financiare vjetore të nenit 2 paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të kësaj rregullore me gjendje të 31 dhjetorit të vitit aktual të punës.

(2) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet shtesë financiare tremujore të nenit 2 paragrafi (2) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të kësaj rregulloreje me gjendje të 31 marsit, 30 qershorit, dhe 31 dhjetorit të vitit aktual të punës.

(3) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të dorëzojnë në Agjenci raportet shtesë financiare vjetore të nenit 2 paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 4), dhe 5) të kësaj rregulloreje brenda datës 1 mars të vitit aktual për vitin e ardhshëm.

(4) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të dorëzojnë në Agjenci raportet shtesë financiare tremujore të nenit 2 paragrafi (2) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të kësaj rregullore në afat prej 30 ditësh nga kalimi i ditës së fundit të periudhës përlogaritëse për të cilën janë përpiluar të njëjtat.

(5) Raportet shtesë financiare të nenit 2 paragrafi (1) dhe (2) të kësaj rregulloreje shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i dorëzojnë në Agjenci në afatet e caktuara në formë elektronike në mënyrë të përcaktuar nga ana e Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve.

### **IV. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare** **Neni 4**

**(Neni 4 nga Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive për sigurim dhe/apo risigurimeve e shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 30/12)**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ndërsa do të fillojë të aplikohet gjatë përpilimit të raporteve shtesë financiare tremujore me gjendje të 30 qershorit 2012, gjegjësisht të raporteve shtesë financiare vjetore me gjendje të 31 dhjetorit viti 2012.

**(Neni 3 nga Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimeve dhe/apo risigurimeve e shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 61/16)**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të aplikohet nga 1 prilli i viti 2016.

(2) Shoqëritë janë të detyruara këtë rregullore ta aplikojnë me përgatitjen e raporteve tremujore për tremujorin e dytë për vitin 2016.

**(Neni 2 nga Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimeve dhe/apo risigurimeve e shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 61/16)**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

**(Neni 7 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve shtesë financiare të shoqërive të sigurimeve dhe/apo risigurimeve e shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut ” nr. 118/22)**

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe do të fillojë të aplikohet gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare shtesë tremujore më 30 qershor të vitit 2022.

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve  
Kërste Shajnoski**



(група)  
(назив на друштво)  
(период)  
(тековна година)

**ВК: Извештај за вложувања на средствата кои не ги покриваат  
техничките/математичката резерва**

Опис на позицијата	Број на позиција	Износ	% од Капиталот (позиција 028)
1	2	3	4
<b>А. ВКУПНИ ВЛОЖУВАЊА НА СРЕДСТВАТА КОИ НЕ ГИ ПОКРИВААТ ТЕХНИЧКИТЕ/МАТЕМАТИЧКАТА РЕЗЕРВА</b>	<b>001</b>		
<b>I. ЗЕМЛИШТЕ И ГРАДЕЖНИ ОБЈЕКТИ (кои служат за вршење на дејност и кои не служат за вршење на дејност)</b>	<b>002</b>		
<b>II. ФИНАНСИСКИ ВЛОЖУВАЊА ВО ДРУШТВА ВО ГРУПА - ПОДРУЖНИЦИ, ПРИДРУЖЕНИ ДРУШТВА И ЗАЕДНИЧКИ КОНТРОЛИРАНИ ЕНТИТЕТИ</b>	<b>003</b>		
II.1. Акции, удели и останати сопственички инструменти во друштва во група - подружници	004		
II.2. Должнички хартии од вредност кои ги издале друштва во група - подружници и заеми на друштва во група - подружници	005		
II.3. Акции, удели и останати сопственички инструменти во придружени друштва	006		
II.4. Должнички хартии од вредност кои ги издале придружени друштва и заеми на придружени друштва	007		
II.5. Останати финансиски вложувања во друштва во група - подружници	008		
II.6. Останати финансиски вложувања во придружени друштва	009		
II.7. Вложувања во заеднички контролирани ентитети	010		
<b>III. ОСТАНАТИ ФИНАНСИСКИ ВЛОЖУВАЊА</b>	<b>011</b>		
III.1. Финансиски вложувања кои се чуваат до доста сување	012		
III.2. Финансиски вложувања расположливи за продажба	013		
1. Должнички хартии од вредност	014		
2. Акции, удели и останати сопственички инструменти	015		
3. Акции и удели во инвестициски фондови	016		
III.3. Финансиски вложувања за тргување	017		
1. Должнички хартии од вредност	018		
2. Акции, удели и останати сопственички инструменти	019		
3. Акции и удели во инвестициски фондови	020		
III.4. Депозити, заеми и останати пласмани	021		
1. Дадени депозити	022		
2. Заеми обезбедени со хипотека	023		
3. Останати заеми	024		
4. Останати пласмани	025		
III.5. Деривативни финансиски инструменти	026		
<b>IV. ФИНАНСИСКИ ВЛОЖУВАЊА КАЈ КОИ ОСИГУРЕНИКОТ ГО ПРЕЗЕМА ИНВЕСТИЦИСКИОТ РИЗИК (ДОГОВОРИ ЗА ОСИГУРУВАЊЕ)</b>	<b>027</b>		
<b>Б. КАПИТАЛ</b>	<b>028</b>		
<b>(позиција V од образецот за Пресметка на капитал (КС))</b>			

(група)  
(назив на друштво)  
(период)  
(тековна година)

### САК: Структура на акционерскиот капитал

		Износ во (000) денари	Учество во вкупниот акционерски капитал (%)
		<b>100</b>	<b>200</b>
<b>1. Странски акционери</b>	<b>1</b>		
1.1. Физички лица	11		
1.2. Нефинансиски правни лица	12		
1.3. Финансиски институции	13		
<b>2. Домашни акционери</b>	<b>2</b>		
2.1. Физички лица	21		
2.2. Нефинансиски правни лица	22		
2.3. Финансиски институции	23		
<b>3. Држава</b>	<b>3</b>		
<b>Вкупен акционерски капитал на друштвото (АОП 086)</b>	<b>0000</b>		

## ANEKSI 2

### UDHËZIM

#### PËR PLOTËSIM TË RAPORTEVE SHITESË FINANCIARE

##### RAPORTET SHITESË FINANCIARE VJETORE

##### 1. RAPORT PËR NORMA JASHTË BILANCIT

###### 1.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në Raportin për norma jashtë bilancit paraqiten shumat e mjeteve dhe obligimeve të caktuara të cilat shoqëritë e sigurimeve i udhëheqin jashtë bilancit. Këto pozicione përfshijnë: kërkesa jo të realizuara të regresit, garanci dhe forma të tjera të garancisë, letra me vlerë dhe letra potenciale me vlerë, investime, fitim potencial dhe rezultate të tjera. Në raport normat janë të ndara në norma aktive jashtë bilancit dhe norma pasive jashtë bilancit.

###### 1.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM TË POZITAVE INDIVIDUALE NË RAPORTIN PËR NORMA JASHTË BILANCIT

###### Përshkrim i pozitave horizontale

Horizontalisht paraqitet gjendja e normave individuale jashtë bilancit të shoqërive për sigurim të periudhës aktuale dhe atë paraprake.

###### Përshkrim i pozitave vertikale

**Norma aktive jashtë bilancit** – paraqet mbledhje të shumave të paraqitura në pozitat nga 002 deri 006.

**Norma pasive jashtë bilancit** – paraqet mbledhje të pozitave të paraqitura në pozitat nga 008 deri 013.

##### 2. RAPORT PËR PAJTUESHMËRI VALUTORE TË MJETEVE DHE OBLIGIMEVE NGA RAPORTI PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)

###### 2.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në Raportin për pajtueshmëri valutore paraqitet gjendja e mjeteve të shoqërisë për sigurim të shpërndara në varësi nga valuta në të cilën shoqëria për sigurim i kërkon mjetet, gjegjësisht i detyron obligimet, si dhe pajtueshmërinë/jo pajtueshmërinë e tyre sipas valutave.

###### 2.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM TË FORMULARIT PËR PAJTUESHMËRI VALUTORE TË MJETEVE DHE OBLIGIMEVE NGA RAPORTI PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCIN E GJENDJES)

###### Përshkrim i pozitave horizontale

Horizontalisht paraqiten pozitat individuale nga Aktiva dhe Pasiva e Raportit për gjendjen financiare (Bilancin e gjendjes) së shoqërisë në varësi nga valuta në të cilën shoqëria i kërkon mjetet, gjegjësisht i detyron obligimet, në: denarë (MKD), në valutë të huaj apo klauzolë valutore të lidhur me euro (EUR), valutë të jashtme apo klauzolë valutore të lidhur me dollar (USD), valutë të huaj apo klauzolë valutore për franga zvicerane (CHF) apo valutë tjetër të huaj apo klauzolë valutore.

### **Përshkrim i pozitave vertikale**

Vertikalisht plotësohen pozitat individuale nga Aktiva dhe Pasiva e Raportit për gjendjen financiare të shoqërisë në mënyrë të definuar në Udhëzimin për plotësim të Raporteve financiare të shoqërisë.

## **3. RAPORT PËR PAJTUESHMËRI TË MATURITETIT TË MJETEVE DHE OBLIGIMEVE NGA RAPORTI PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)**

### **3.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në raportin për pajtueshmëri të maturitetit paraqitet gjendja e mjeteve të shoqërisë për sigurim, të shpërndara sipas periudhave sipas maturitetit të dakorduar të ngelur të mjeteve, gjegjësisht obligimeve.

### **3.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT PËR PAJTUESHMËRI TË MATURIMIT TË MJETEVE DHE OBLIGIMEVE NGA RAPORTI PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)**

#### **Përshkrim i pozitave horizontale**

Horizontalisht paraqiten pozitat individuale të Aktivës dhe Pasivës nga Raporti për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes) të shoqërisë në periudha sipas maturitetit të dakorduar të ngelur të mjeteve (periudha deri më 1 vit, prej 1 deri 3 vite, prej 3 deri 5 vite, prej 5 deri 10 vite, prej 10 deri 15 vite, prej 15 deri 20 vite, si dhe 20 e më shumë vite).

#### **Përshkrim i pozitave vertikale**

Vertikalisht plotësohen pozitat individuale nga Aktiva dhe Pasiva e Raportit për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes) të shoqërisë në mënyrë të definuar në Udhëzimin për plotësim të Raporteve financiare të shoqërisë.

## **4. RAPORT PËR TRANSAKSIONE ME PERSONA TË NDËRLIDHUR**

### **4.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në raportin për transaksione me persona të ndërlidhur paraqiten transaksionet në kuptim të transferimit të resurseve, shërbimeve apo obligimeve ndërmjet shoqërisë për sigurim dhe palëve të ndërlidhura me të në përputhje me MSS 24 – Deklarimi i palëve të ndërlidhura. Në Raportin veçmas paraqiten transaksionet të cilat shoqëria i ka realizuar me shoqërinë e tij amë, entitetet të cilat kanë kontroll apo ndikim të dukshëm mbi shoqërinë, filialet e saj, filialet e afërta në korniza të grupit, shoqëritë e bashkangjitura, investime të përbashkëta në të cilat shoqëria është anëtare në investimin e përbashkët, stafi kryesor udhëheqës dhe personat të tjerë të ndërlidhur.



#### **4.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT PËR TRANSAKSIONE ME PERSONA TË NDËRLIDHURA**

##### **Përshkrim i pozitave horizontale**

Në pozitat horizontale paraqiten transaksionet të cilat shoqëria për sigurim i ka realizuar me kategoritë e ndryshme (llojet) të personave të ndërlidhur (shoqëri amë, entitete të cilat kanë kontroll të përbashkët apo ndikim të dukshëm mbi shoqërinë, filialet e saj, filialet e afërta në korniza të grupit, shoqëritë e tij të bashkangjitura, investime të përbashkëta në të cilat shoqëria është anëtare në investimin e përbashkët, stafi kryesor udhëheqës dhe persona të tjerë të ndërlidhur).

##### **Përshkrim i pozitave vertikale**

Në pozitat vertikale paraqiten shumat e transaksioneve të caktuara me personat e ndërlidhur të shpërndarë nëpër mjete dhe obligime të veçanta, të ardhura dhe shpenzime.

#### **RAPORTE SHITESË FINANCIARE TREMUJORE**

#### **5. RAPORT PËR TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INVESTIMET**

##### **5.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në Raportin për të ardhura dhe shpenzime nga investimet paraqiten të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga investimet, të ndara në varësi të burimit të mjeteve (investime nga provigjonet teknike, provigjoni matematik apo nga mjetet e tjera të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike). Shumat e paraqitura në pozitat të ardhura totale dhe shpenzime totale duhet të përputhen me shumat e paraqitura në pozitat adekuate në Raportin për fitim të përgjithshëm (Bilanc i suksesit).

##### **5.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM TË RAPORTIT PËR TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INVESTIMET**

##### **Përshkrim i pozitave horizontale**

Horizontalisht plotësohen pozitat e të ardhurave dhe shpenzimeve të ndara në kolonat adekuate në varësi të burimit të mjeteve (të ardhura dhe shpenzime të realizuara nga investimet nga provigjonet teknike, provigjoni matematik apo nga mjete të tjera të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike).

##### **Përshkrim i pozitave vertikale**

Vertikalisht plotësohen pozitat individuale të të ardhurave, gjegjësisht Shpenzime nga investimet nga Raporti për fitim të përgjithshëm të shoqërisë për sigurim në mënyrë të definuar në Udhëzimin për plotësim të Raporteve financiare të shoqërisë, të ndara në lloje të të ardhurave, gjegjësisht shpenzimeve (të ardhura nga filialet, shoqëri të bashkangjitura, entitete të përbashkëta të kontrolluara, të ardhura nga investimet në toka dhe objekte ndërtimi etj).

## 6. RAPORT PËR FITIME (HUMBJE) TË REALIZUARA NGA SHITJA – FITIMI KAPITAL (HUMBJA)

### 6.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në Raportin për fitime (humbje) të realizuara nga shitja – fitimi kapital (humbja), paraqiten fitimet, gjegjësisht humbjet e realizuara gjatë shitjes së mjeteve të caktuara të shoqërive për sigurim, të klasifikuara në portofolin e instrumenteve në dispozicion për shitje, në portofolin e instrumenteve të ruajtura për tregtim dhe toka dhe objekte ndërtimi.

### 6.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E PASQYRËS PËR FITIME (HUMBJE) TË REALIZUARA NGA SHITJA FITIMI KAPITAL (HUMBJA)

#### Përshkrim i pozitave horizontale

**Emri** – paraqet emrin e mjetit me shitjen e të cilit shoqëria për sigurim ka realizuar fitim kapital, gjegjësisht humbje.

**Klasifikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)** – shënohet emri i shkurtuar i grupit adekuat të Raportit për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes), për:

IP – Tokë dhe objekte ndërtimi

IG – Investime financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara

- HTM – Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- AFS – Investime financiare në dispozicion për shitje
- HFT – Investime financiare për tregtim
- L/R – Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IO – Investime të tjera financiare

- HTM - Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- AFS - Investime financiare në dispozicion për shitje
- HFT - Investime financiare për tregtim
- L/R - Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IR – Investime financiare tek të cilat rrezikun e merr i siguruari

C/E – Mjete financiare dhe ekuivalente të tjera të hollash

Në bazë të këtij raporti lejohen klasifikimet AFS, HFT dhe IP.

**Numri i letrave me vlerë** – paraqet numrin e letrave me vlerë (debitore, pronësore) me shitjen e të cilave është realizuar fitimi kapital, gjegjësisht humbja. Kjo pozitë nuk plotësohet në bazë të pozitës Tokë dhe objekte ndërtimi.

**Vlerë kontabiliste** – paraqet shumë sipas së cilës mjeti është evidentuar në librat e punës së shoqërisë për sigurim deri në datën e shitjes (tjetërsimit).

**Vlera shitëse** – paraqet shumë të cilën shoqëria për sigurim e kërkon apo e ka paguar gjatë shitjes së mjetit të caktuar.

**Fitim (humbje) i/e realizuar** – paraqet shumë të fitimit, gjegjësisht humbjes të cilën shoqëria për sigurim e ka realizuar me shitjen e mjetit të caktuar. E njëjta paraqet dallimin ndërmjet vlerës shitëse dhe kontabiliste të mjetit.

**Burim i fondeve**- paraqet burimin e fondeve nga të cilat janë kryer investimet, për:

- IPT ka të bëjë me investimet e fondeve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike,
- IPM ka të bëjë me investimin e fondeve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik,
- IK ka të bëjë me investimet e fondeve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike.  
timeve të fondeve që nuk mbulojnë rezervat matematikore dhe/ose teknike.
- IR i referohet investimeve të fondeve ku i siguruari merr përsipër rrezikun dhe mbulon rezervën speciale."

### **Përshkrim i pozitave vertikale**

Në pozitat vertikale paraqitet përshkrim/shumë në përputhje me pozitat horizontale, të ndara sipas mjeteve/instrumenteve të veçanta (tokë dhe objekte ndërtimi të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë, tokë dhe objekte ndërtimi të cilat nuk shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë, aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara, letra debitore me vlerë të cilat i kanë botuar shoqëri në grup, filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara etj.)

## **7. RAPORT PËR PËRSHTATSHMËRI TË VLERËS (FITIME (HUMBJE) JO TË REALIZUARA, ULJE E VLERËS OBJEKTIVE)**

### **7.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në Raportin për pajtueshmëri të vlerës (fitime jo të realizuara (humbje), ulje të vlerës objektive paraqiten fitimet jo të realizuara, gjegjësisht humbjet e realizuara me përshtatshmërinë e vlerës së mjetit të klasifikuar në portofolin e instrumenteve në dispozicion për shitje dhe në portofolin e instrumenteve të ruajtura për tregtim, si dhe investimet për tokë dhe objekte ndërtimi.

### **7.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT PËR PËRSHTATSHMËRI TË VLERËS (FITIME JO TË REALIZUARA (HUMBJE), ULJE E VLERËS OBJEKTIVE)**

#### **Përshkrim i pozitave horizontale**

**Emri** – paraqet emrin e mjetit me përshtatshmërinë e vlerës të së cilit shoqëria për sigurim ka vërtetuar fitim jo të realizuar, gjegjësisht humbje.

**Klasifikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)** – shënohet emri i shkurtuar i grupit adekuat të Raportit për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes), për:

IP – Tokë dhe objekte ndërtimi

IG – Investime financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara

- HTM - Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- AFS - Investime financiare në dispozicion për shitje
- HFT - Investime financiare për tregtim
- L/R - Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IO – Investime të tjera financiare

- HTM - Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- AFS - Investime financiare në dispozicion për shitje
- IO - HFT - Investime financiare për tregtim
- L/R - Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IR – Investime financiare tek të cilat rrezikun e merr i siguruari

C/E – Mjete financiare dhe ekuivalente të tjera të hollash

Në bazë të këtij raporti lejohen klasifikimet HFT, AFS dhe IP.

**Metoda e vlerësimit** – shënohet mënyra e matjes/përcaktimit të shumave monetare sipas të cilave njihen elementet e raporteve financiare, në varësi nga trajtimi kontabilist i investimit adekuat.

Shembuj: MSS 16 – model i shpenzimeve/model i rivlerësimit, MSS 40 – model i vlerës objektive/model i vlerës furnizuese, MSS 39 – model i vlerës objektive/model i vlerës amortizuese furnizuese pas aplikimit të metodës së EKS dhe ngjashëm.

**Data e vlerësimit të fundit** – ka të bëjë me datën e vlerësimit të fundit, gjegjësisht përshtatshmëri të vlerës të mjetit deri në vlerën e tij objektive (të drejtë).

**Vlera kontabiliste** – paraqet shumës sipas së cilës është evidentuar mjete në regjistrat e punës së shoqërisë për sigurim deri në datën e vlerësimit të tij të fundit, gjegjësisht përshtatshmëri të vlerës.

**Vlerë objektive e datës së vlerësimit të fundit** – paraqet shumën për të cilën mjete mund të shkëmbehet, apo obligimi i shlyer në transaksion nën kushte komerciale, ndërmjet anëve mjaft të informuara dhe të gatshme që ta pranojnë transaksionin vullnetarisht, në datën e vlerësimit të fundit.

**Efekt nga rivlerësimi** – ka të bëjë me efektin i cili ka dalë nga përshtatshmëria e vlerës së instrumentit financiar apo mjetit material, ndërsa evidentohet si rritje apo ulje e provigjonit rivlerësues të paraqitur në pasivën e Raportit për gjendje financiare (Bilanc i gjendjes). Ka të bëjë ekskluzivisht me instrumentet financiare të klasifikuara në portofolin e instrumenteve financiare në dispozicion për shitje dhe investime në tokë dhe në objekte ndërtimi.

**Provigjon rivlerësues (gjendje)** – e paraqet gjendjen e përgjithshme të provigjonit rivlerësues, gjegjësisht të gjitha efektet të cilat kanë dalë nga përshtatshmëria e vlerës së investimeve financiare të klasifikuara në portofolin e instrumenteve financiare në dispozicion për shitje dhe investime në tokë dhe në objekte ndërtimi.

**Përshtatshmëri e vlerës (fitime jo të realizuara, ulje e vlerës objektive) e njohur direkt në BS** – ka të bëjë me efektin i cili ka dalë nga përshtatshmëria e vlerës së mjetit të caktuar, ndërsa evidentohet si rritje, gjegjësisht ulje të fitimit/humbjes në Raportin për fitim të përgjithshëm (Bilanc të suksesit). Ka të bëjë ekskluzivisht me instrumente financiare të klasifikuara në portofolin e instrumenteve financiare të ruajtura për tregti dhe tokë dhe objekte të ndërtimit.

**Dallimi neto i kursit** – paraqet dallimin neto të kursit.

**Amortizim i zbritjes/primit tek instrumentet financiare me afat fiks të maturimit** – paraqet amortizimin e zbritjes/primit tek instrumentet financiare me afat fiks të maturimit.

**Burimi i mjeteve**- paraqet burimin e mjeteve nga të cilat janë kryer investimet, për:

- IPT ka të bëjë me investimet e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike,
- IPM ka të bëjë me investimin e mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik,
- IK ka të bëjë me investimet e mjeteve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike.

## **Përshkrim i pozitave vertikale**

Në pozitat vertikale paraqitet përshkrim/shumë në përputhje me pozitat horizontale, të ndara sipas mjeteve/instrumenteve të veçanta (tokë dhe objekte ndërtimi të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë, aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronësie në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara etj.)

## **8. RAPORT PËR INVESTIME TË CILAT NUK I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE DHE/APO PROVIGJONIN MATEMATIK**

### **8.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në Raportin për investime të cilat nuk i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo provigjonin matematik paraqitet lokalizimi i të gjitha investimeve të shoqërisë për sigurim të cilat nuk llogariten si lloje të lejuara të investimeve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike dhe të cilat nuk janë më të paraqitura në formularët IPT dhe IPM, në përputhje me Rregulloren për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim direkt dhe kufizim i këtyre investimeve, si dhe vlerësimi i tyre.

## 8.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT PËR INVESTIME TË CILAT NUK I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE DHE/APO PROVIGJONIN MATEMATIK

### Përshkrim i pozitave horizontale

Në pozitën horizontale paraqiten shumat e investimeve të shoqërisë të ndara sipas llojeve të investimeve në përputhje me Formularin – Raport për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes).

### Përshkrim i pozitave vertikale

Në pozitën vertikale paraqitet shuma e vlerës së tanishme të secilit grup individual të investimeve e paraqitur në pozitën horizontale dhe pjesëmarrja e saj me përqindje në kapitalin e shoqërisë (shumë e paraqitur në pozitën V të formularit për Përlllogaritje të kapitalit).

## 9. RAPORT PËR STRUKTURËN E INVESTIMEVE

### 9.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në Raportin për strukturën e investimeve paraqitet struktura e detajuar dhe karakteristikat e të gjitha investimeve të shoqërisë për sigurim (**investime të mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike dhe investime të tjera të mjeteve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike**). Ato janë investime të bëra në përputhje me Rregulloren për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo provigjonin matematik dhe mjeteve të cilat nuk i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre, të paraqitura në formularët adekuat IPT dhe IPM, si dhe investime **të mjeteve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike** të shoqërisë (nga kapitali, gjegjësisht mjetet personale), të paraqitura në formularin adekuat IK.

Investimet e paraqitura në këtë raport (sipas vlerës dhe sipas llojeve të instrumenteve) duhet të bashkëpërbëjnë me investimet e shoqërisë të paraqitura në pozitën në Raportin për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes) të shoqërisë.

Raporti për strukturë të investimeve nuk e përfshin strukturën e kërkesave jo të maturuara të shoqërisë, edhe pse të njëjtat si shumë të kërkesave jo të maturuara llogariten për mjete të cilat i mbulojnë provigjonet teknike/matematik në përputhje me nenin 4 paragrafi (2) të Rregullores për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo provigjonin matematik dhe mjeteve të cilat nuk i mbulojnë provigjonet teknike dhe/apo provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre.

### 9.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT PËR STRUKTURËN E INVESTIMEVE

Në Raport plotësohen vetëm fushat të cilat janë të përshtatshme për llojin adekuat të instrumentit.

**Burim i mjeteve** – paraqet burim të mjeteve nga të cilat janë kryer investimet, për:

- IPT ka të bëjë me investimet e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike. Vlera e investimeve të paraqitura në formularin SIn në pjesën e investimeve të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike duhet të përshtatet me vlerën e investimeve të paraqitura në formularin IPT e zvogëluar për vlerën e kërkesave të cilat janë pjesë përbërëse e pozitës I26 nga formulari IPT;

## Tekst i konsoliduar jozyrtar

- IPM ka të bëjë me investimet e mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik. Vlera e investimeve të paraqitura në formularin SIn në pjesën e investimeve të mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik duhet të përshtatet me vlerën e investimeve të paraqitura në formularin IPT e zvogëluar për vlerën e kërkesave të cilat janë pjesë përbërëse e pozitës I26 nga formulari IPM; dhe
- IK ka të bëjë me investimet e mjeteve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike. Vlera e investimeve të paraqitura në formularin SIn në pjesën e investimeve të mjeteve të cilat nuk e mbulojnë provigjonin matematik dhe/apo provigjonet teknike duhet të përshtatet me vlerën e investimeve të paraqitura në formularin IK.

**Numri i pozitës në BGJ** – shënohet numri i pozitës nga Raporti për gjendjen financiare – Bilanci i gjendjes (BGJ) i shoqërisë ku është evidentuar investimi.

**Lloji i investimit dhe nënloji i investimit** – paraqet lloj dhe nënloj të investimit në përputhje me tabelën në vijim:

**Tabela: Tipi dhe nëntipi i instrumentit/llojit të investimit**

Tipi i instrumentit/lloji i investimit	Nëntip i instrumentit/nënloji i investimit
I. Letra pronësie me vlerë	1. Aksione të thjeshta 2. Aksione me prioritet 3. Aksione të fondeve të mbyllura investuese
II. Letra debitore me vlerë	1. Regjistrime 2. Obligacione 3. Obligacione të konvertueshme
III. Pjesë	1. FI të hapura 2. FI private 3. Pjesë në shoqëri tregtare
IV. Të holla dhe mjete të hollash	1. Mjete të hollash në arkë 2. Mjete në llogari bankare
V. Depozita në bankë	1. Depozita me afat 2. Depozita me transferim
VI. Patundshmëri	1. Tokë për kryerjen e veprimtarisë 2. Objekte ndërtimi për kryerjen e veprimtarisë 3. Tokë e cila nuk është për kryerjen e veprimtarisë 4. Objekte ndërtimi të cilat nuk janë për kryerjen e veprimtarisë.
VII. Hua dhe paradhënie	1. Hua 2. Paradhënie (polica për jetë)
VIII. Të tjera	

**Garanci** – shënohet emri i emituesit të garancisë së investimit.

**Emri i emetuesit (kontraktuesit)** - Shënohet emri i emetuesit të letrave me vlerë, pjesa, banka ku janë plasuar mjetet, shfrytëzuesi i huasë apo paradhënies, gjegjësisht përshkrimi i pronës së patundshme (parcelë e kadastrës, numër i fletëpronësisë)

**Sektor/nën sektor i emituesit (kontraktuesit)** – shënohet emri i sektorit/nën sektorit në përputhje me përkufizimet e rregulluara në Rregulloren për plan kontabël të shoqërive për sigurim dhe risigurim, për:

Shoqëri jo financiare / Private  
Shoqëri jo financiare / Publike  
Shtet/ Qeveri qendrore  
Shtet / Vetëqeverisje lokale  
Shoqëri financiare / Banka Qendrore  
Shoqëri financiare / Banka  
Shoqëri financiare / Fonde të investimit  
Shoqëri financiare / Të tjera

**ISIN kod i LV / emri i fondit** – shënohet ISIN (International Securities Identification Number) i letrës me vlerë apo emri i fondit.

**Shenjë** – shënohet shenja e letrave me vlerë nga Depozitari qendror për letra me vlerë në tregun vendor, gjegjësisht nga institucioni depozitar jashtë vendit; llogari në bankë (të transaksionit apo devizave), numër i kontratës për depozitë; kontrata për hua apo paradhënie; lista e pronës.

**Sasia** – shënohet numri i letrave me vlerë/pjesëve.

**Klasifikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)** – shënohet emri i shkurtuar i grupit adekuat nga Raporti për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes), dhe atë:

IP – Tokë dhe objekte ndërtimi

IG – Investime financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara

- IG - HTM - Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- IG - AFS - Investime financiare në dispozicion për shitje
- IG - HFT - Investime financiare për tregtim
- IG - L/R - Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IO – Investime të tjera financiare

- IO - HTM - Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim
- IO - AFS - Investime financiare në dispozicion për shitje
- IO - HFT - Investime financiare për tregtim
- IO - L/R - Depozita, hua dhe plasmane të tjera

IR – Investime financiare tek të cilat rrezikun e merr i siguruari

C/E – Mjete të hollash dhe ekuivalente të tjerë të hollash



**Metoda e vlerësimit** – shënohet mënyra e matjes/përcaktimit të shumave monetare sipas të cilave njihen elementet e raporteve financiare, në varësi nga trajtimi kontabilist i investimit adekuat.

Shembuj: MSS 16 – model i shpenzimeve/model i rivlerësimit, MSS 40 – model i vlerës objektive/model i vlerës furnizuese, MSS 39 – model i vlerës objektive/model i vlerës amortizuese furnizuese pas aplikimit të metodës së EKS dhe të ngjashme.

**Shteti i emetuesit (kontraktuesit)** – shënohet ISO 3166 kodi i shtetit të emetuesit (kontraktuesit)

**Shteti i tregtimit** – shënohet ISO 3166 kodi i shtetit ku është blerë instrumenti.

**Treg i rregulluar i tregtimit** – shënohet emri i tregut të rregulluar (bursë, tregje përmes sportelit apo platformës multilaterale tregtare (PMT) ku është blerë instrumenti.

**Burim i vlerësimit** – shënohet burimi i të dhënës për vlerësim (p.sh. metoda e normës efektive të interesit, emri i bursës, shoqëria për menaxhim me fondet investuese dhe ngjashëm.).

**Vlera furnizuese** – shënohet vlera furnizuese.

**Interesi i akumuluar** – shënohet interesi nga fillimi i periudhës së kuponave ku kryhet tregtimi deri në datën e raportit.

**Shpenzim i amortizuar** – shënohet shuma e shpenzimit të amortizuar.

**Vlera objektive**- shënohet vlera objektive (e drejtë) e investimit të datës së Raportit.

**Vlera kontabiliste** – shënohet vlera kontabiliste e investimit e cila bashkëvepron me pozitën e paraqitur në Raportin për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes) të shoqërisë deri në datën e raportit.

**Vlera kontabiliste në valutë origjinale** – shënohet vlera kontabiliste në vlerë origjinale sipas kursit të mesëm të BPRM.

**Valuta**- shënohet kodi ISO 4217 i valutës.

**Lloji i kuponit** – shënohet lloji i kuponit, dhe atë fiks/i ndryshueshëm.

**Frekuencë e kuponit** – shënohet frekuenca e kuponit, dhe atë 1 (vjeçar), 2 (gjysme vjeçar), 4 (tremujor) apo 12 (mujo).

**Norma e interesit** – shënohet norma nominale e interesit (p.sh. shuma e normës së interesit apo mënyra e formimit të normës së interesit LIBOR, EURIBOR plus shtojcë).

**Norma efektive e interesit/rendiment** – shënohet norma efektive e interesit në nivel vjetor, gjegjësisht rendimenti i cili realizohet nga investimi me 4 pozita decimale.

**Data e investimit** – shënohet data në të cilën është kryer investimi i mjeteve/shlyerja. Kjo datë ka të bëjë me datën e fundit në të cilën është kryer investimi i mjeteve/shlyerja. Në rast kur në periudhën raportuese ka më shumë ngjarje, detalet jepen si shënim shtesë.

**Data e maturimit** – shënohet data e maturimit të instrumenteve debitore/fundi i shumës kontraktuese.

**Gradë** – shënohet grada e botuesit/kontraktuesit.

**Agjenci gradimi** – shënohet agjencia e gradimit të botuesit/kontraktuesit.

## **"10. RAPORTI I STRUKTURËS SË KAPITALIT AKSIONAR**

### **10.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Raporti i Strukturës së Kapitalit Aksionar paraqet të dhëna për strukturën e kapitalit aksionar të shoqërive të sigurimeve.

### **10.2 UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT TË STRUKTURËS SË KAPITALIT TË AKSIONARËVE**

Pozicionet horizontale plotësohen me të dhëna për kapitalin aksionar, të cilat klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

1. Aksionerët e huaj
  - 1.1. Personat fizikë
  - 1.2. Personat juridikë jofinanciare
  - 1.3. Institucionet financiare
2. Aksionerët vendas
  - 2.1. Personat fizikë
  - 2.2. Personat juridikë jofinanciare
  - 2.3. Institucionet financiare
3. Shteti

Për secilin grup të aksionarëve në veçanti është paraqitur shuma e kapitalit të nënshkruar (në mijë denarë) dhe përqindja e tij në kapitalin total të nënshkruar të shoqërisë (pika I. Kapitali i nënshkruar (AOP 086)) nga Bilanci i gjendjes).